

POLITIKA PËR GJURMUESHMËRIN E MATJEVE

DAK-PO-06

MIRATUAR NGA,
DREJTORE E PËRGJITHSHME
Gentiana ISLAMAJ

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS	4
6. ANEKSET	6
7. REGJISTRAT	6
8. HISTORIA	6

1. FUSHA

Ky dokument përshkruan politikën e DAK-së lidhur me gjurmueshmërinë e matjeve. Kjo politikë mund të zbatohet gjithashtu edhe për aktivitete tjera të vlerësimit të konformitetit ku përfshihet testimi dhe/ose kalibrimi (p.sh. inspektimi, certifikimi i produktit).

DAK ka përcaktuar politikën në vijim për të siguruar zbatimin e kërkesave të ILAC P10:2013 për gjurmueshmërinë e rezultateve të matjeve.

2. REFERENCAT

- ISO/IEC 17011:2017 Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë trupat e vlerësimit të konformitetit
- ISO/IEC 17025:2017 Kërkesat e përgjithshme për kompetencat e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit
- ISO/IEC 17020:2012 Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për operimin e llojeve të ndryshme të trupave që kryejnë inspektim
- ISO/IEC 17034:2016 Kërkesat e përgjithshme për kompetencën e prodhuesve të materialeve referuese
- ILAC P10:2013 ILAC Politika për gjurmueshmërinë e rezultateve të matjes.

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë është e detyrueshme dhe vlen për të gjithë stafin e brendshëm dhe të jashtëm të DAK-së që janë të përfshirë në akreditim (siç janë stafi i DAK-së, KP, KA, KT, vlerësuesit dhe ekspertët) dhe TVK-të e akredituara ose që kërkojnë akreditim nga DAK.

Kjo politikë vlen për të gjitha pajisjet e përdorura në laboratorë, që janë të akredituara apo kërkojnë akreditim nga DAK dhe që kanë ndikim të konsiderueshëm në saktësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të testimit, kalibrimit ose mostrimit.

Gjithashtu mund të vlejë edhe për TVK të tjerë që janë të përfshirë në aktivitetet e testimit dhe/ose kalibrimit (trupat e inspektimit dhe certifikimit).

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllimin e kësaj politike përdoren termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

KA	Këshilli i Akreditimit
BIPM	Bureau International des Poids et Mesures (Byroja Ndërkombëtare e Peshave dhe Masave)

BIPM KCDB	Key comparison database of BIPM (Baza e të dhënave e krahasimeve kryesore e BIPM)
TVK	Trupi për vlerësimin e konformitetit
CIPM	International Committee for Weights and Measures (Komiteti Ndërkombëtar për Pësha dhe Masa)
CIPM MRA	Mutual Recognition Agreement of CIPM (Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të CIPM)
DAK	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
EA	European Accreditation (Bashkëpunimi Evropian për Akreditim)
EA MLA/BLA	European Accreditation Multilateral Agreement/Bilateral Agreement (Marrëveshja për njohjen shumëpalëshe/dypalëshe të EA-së)
ILAC	International Laboratory Accreditation Council (Këshilli Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorëve)
MRA/ILAC	Mutual recognition arrangement of ILAC (Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të ILAC-së)
IKM	Instituti Kombëtar i Metrologjisë - AMK
KP	Këshilli Profesional
SI	Sistemi Ndërkombëtar i Njësive
KT	Komitetet Teknike

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

TVK-të e akredituara nga DAK demonstrojnë që kalibrimi i pajisjeve kritike dhe rrjedhimisht, rezultatet nga kalibrimi, inspektimi ose testimi që gjenerohen nga ato pajisje, të cilat janë relevante për fushën e tyre të akreditimit, janë të gjurmueshme deri tek Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (Njësitë e SI-së).

DAK, si pajisje "kritike" që përdoren nga laboratorët e testimit dhe kalibrimit dhe nga trupat inspektues, i konsideron ato pjesë të pajisjeve që janë të nevojshme për të kryer një testim, kalibrim ose inspektim për fushën e akreditimit, dhe të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm në pasigurinë e matjes së rezultatit të testimit, kalibrimit ose inspektimit.

Laboratorët e akredituar për kalibrimin e pajisjeve dhe ato që janë relevante për fushën e tyre të akreditimit, duhet në të gjitha rastet, kur është e mundur, të derivojnë gjurmueshmërinë e tyre qoftë nga:

a) Nga një Institut Kombëtar i Metrologjisë (AMK), shërbimi i të cilit është i përshtatshëm për nevojën e synuar dhe mbulohet nga Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të CIPM (CIPM MRA). Shërbimet e mbuluara nga CIPM MRA janë të paraqitura në Shtojcën C të BIPM KCDB ku përfshihet gama dhe pasiguria për çdo shërbim të listuar. (rruga 1)

ose

b) Nga një laborator i akredituar i kalibrimit, shërbimi i të cilit është i përshtatshëm për nevojën e synuar (d.m.th fusha e akreditimit mbulon në mënyrë specifike kalibrimin e duhur) dhe Trupi i Akreditimit mbulohet nga EA MLA ose ILAC MRA për fushën e kalibrimit (rruga 2)

ose

c) Nga një IKM - AMK, shërbimi i të cilit është i përshtatshëm për nevojën e synuar, por nuk mbulohet nga CIPM MRA. (rruga 3a)

ose

d) Nga një laborator i kalibrimit, shërbimi i të cilit është i përshtatshëm për nevojën e synuar, por nuk mbulohet nga EA MLA/BLA ose ILAC MRA për fushën e kalibrimit. (rruga 3b)

Zgjedhja e rrugëve 3a ose 3b të gjurmueshmërisë aplikohet vetëm për llojet e kalibrimeve për të

cilat rrugët 1 ose 2 nuk janë të mundshme. Për një lloj të caktuar të kalibrimit, kur vetëm rrugët 3a dhe 3b janë në dispozicion, zgjidhet rruga 3a.

Në rast se laboratori i kalibrimit është duke përdorur rrugën 3a ose 3b, DAK kërkon që laboratorët e kalibrimit të:

- mbajnë dëshmi të certifikatës së kalibrimit që përmban të gjitha sa vijon:
 - a) rezultatin e kalibrimit;
 - b) pasigurinë e matjes të raportuar si pasiguria e zgjeruar me një faktor të përcaktuar të mbulimit "k" (në mënyrë tipike $k=2$) dhe një interval konfidence (në mënyrë tipike për të përafëruar nivelin 95% të konfidencës);
 - c) një tregues i standardit (eve) referencë që përdoren për të kryer kalibrimin;
- mbajnë dëshmi që standardi (et) referencë të shënuar në certifikatën e kalibrimit janë të gjurmueshëm deri tek SI përmes IKM-së (ose ekuivalente) ose një laborator të akredituar;
- mbajnë dëshmi të intervalit të kalibrimit për pajisjet matëse dhe testuese ose për standardin referencë.
- ofrojnë dëshmi lidhur me pajtueshmërinë me kërkesat e ISO/IEC 17025:2017 për pikat në vijim:
 - a) Regjistrat e validimit të metodës së kalibrimit
 - b) Procedurat për vlerësimin e pasigurisë
 - c) Dokumentimi për gjurmueshmërinë e matjeve
 - d) Dokumentimi për të siguruar cilësinë e rezultateve të kalibrimit
 - e) Dokumentimi për kompetencat e stafit
 - f) Dokumentimi për kushtet akomoduese dhe mjedisore
 - g) Auditimet e laboratorit të kalibrimit.

Në rast se laboratori i kalibrimit përdor materiale referuese, ato do të merren nga:

a) Instituti Kombëtar i Metrologjisë (AMK) ose instituti i caktuar, vlerat e të cilit janë të përfshira në bazën e të dhënave BIPM KCDB,

ose

një material referues i prodhuar nga një prodhues materialesh referuese i akredituar me ISO/IEC 17034:2016 në kombinim me ISO/IEC 17025:2017, do të konsiderohet të ketë përcaktuar një gjurmueshmëri valide.

Shënim 1: Disa IKM-AMK, gjithashtu mund të tregojnë (indikojnë) që shërbimi i tyre mbulohet nga CIPM MRA duke vendosur logon e CIPM MRA në certifikatat e tyre të kalibrimit, megjithatë vendosja e logos nuk është e detyrueshme dhe BIPM KCDB mbetet burimi autoritar i verifikimit.

Shënim 2: IKM-AMK nga shtetet anëtare pjesëmarrëse në Konventën e Matësve (Metre Convention) mund të marrin gjurmueshmëri direkt nga matjet e bëra në BIPM. KCDB-ja siguron një lidhje (link) automatike me shërbimet përkatëse të kalibrimit të BIPM-së (përfshirë gamën dhe pasigurinë). Gjithashtu janë të renditura edhe certifikatat e kalibrimit individual.

Për materialet referuese të prodhuara nga prodhuesit jo të akredituar dhe të cilat janë kritike për kryerjen e testimit, laboratorit duhet të demonstroj që çdo material referues ose material referues i certifikuar është i përshtatshëm për përdorimin e tij të synuar, siç kërkohet nga pika 6.5.3 e ISO/IEC 17025:2017.

Laboratorët mund të pranojnë shërbime të kalibrimit nga laboratorë jo të akredituar të kalibrimit nëse pajisjet matëse nuk kanë ndikim të konsiderueshëm në saktësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të gjeneruara. Në këtë rast, laboratorët duhet të kërkojnë certifikata të kalibrimit të standardeve të tyre nga një laborator jo i akredituar, të cilat përmbajnë informacionin dhe dëshmitë e gjurmueshmërisë së tyre tek niveli më i lartë i standardeve, siç janë standardet e Institutit Kombëtar të Metrologjisë-AMK të njohura nga BIMP MRA dhe/ose laboratorët e kalibrimit të akredituar nga një trup nënshkrues kombëtar i akreditimit EA MLA/BLA ose ILAC MRA.

6. ANEKSET

Nuk aplikohet

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara
02.12.2015	Ibush Luzha	Dokument i ri.
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01